



Testimi i Integritetit të Policisë





Për këtë përmbledhje tematike

Kjo përmbledhje është rezultat i Programit të Reformës Policore të DCAF, me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Pikëpamjet e shprehura janë opinione personale të autorëve dhe nuk reflektojnë pikëpamjet e institucioneve që përmenden ose që përfaqësohen në këtë botimi.

Shënim

DCAF inkurajon përdorimin, përkthimin dhe shpërndarjen e këtij botimi. Megjithatë, DCAF vlerëson se duhet të njihet burimi i botimit, të citohen materialet e shfrytëzuara dhe mos ndryshohet përmbajtja.

Për DCAF

DCAF – Qendra për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë në Gjenevë është një fondacion ndërkombëtar, misioni i të cilës është të ndihmojë bashkësinë ndërkombëtare në përpjekjet për qeverisje të mirë dhe reformimin e sektorit të sigurisë. DCAF zhvillon dhe promovon norma dhe standarde, realizon kërkime të përshtatura të politikave, identifikon praktika dhe rekomandime të nevojshme për të promovuar qeverisje demokratike të sektorit të sigurisë, si dhe siguron mbështetje këshilluese dhe programe për ndihmë praktike në vendet përkatëse.

ISBN:

© 2020 DCAF – Geneva Centre for Security Sector Governance

Testimi i integritetit të policisë

Konteksti

Kjo Përmbledhje Tematike u ofron pjesëmarrësve në proces hyrje në testimin e integritetit. Ajo hulumton përkufizimin e testimit të integritetit, dallimet që ka me monitorimin e stilit të jetës, përfitimet nga zbatimi i testeve të integritetit dhe çka duhet të merren parasysh para dhe gjatë zbatimit të tyre.

Ajo bazohet në kontribute tjera eksperte, **Doracakun për Integritetin e Policisë** dhe **Doracakun e Trajnimit për Integritetin e Policisë**, të zhvilluar nga Programi i Ndërtimit të Integritetit të Policisë PNIP (PIBP) në DCAF. PNIP synon të mbështesë vendet në zhvillimin që shprehin interes për një gjë të tillë, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve të ndërmarra për krijimin dhe përkujdesjen e shërbimeve policore që funksionojnë në nivel më të lartë integriteti dhe profesionalizmi. Kjo përmbledhje siguron udhëzime për një spektër të gjerë pjesëmarrësish (përfshirë zyrtarët qeveritarë, vendimmarrësit dhe udhëheqësit e nivelit të lartë e të mesëm të policisë) se si të zhvillojnë dhe mbështesin shërbimet policore që funksionojnë në përputhje me standardet demokratike të llogaridhënies, transparencës dhe respektit për të drejtat e njeriut.

Koncepte kyçe

Integriteti: Parimi për të pasur në vazhdimësi sjellje në përputhje me vlerat etike. Parimi i integritetit është i rëndësishëm si për individët, ashtu edhe për organizatat. Integriteti individual paraqet forcën morale të sinkronizimit të sjelljes me vlerat etike. Integritet organizativ ka kur një organizatë funksionon në një vijë me një gamë vlerash etike, qartë të definuara.

Korrupsioni: Keqpërdorimi i funksionit publik për përfitime personale, qoftë ato materiale apo jomateriale. Korrupsioni është një lloj sjellje e pahijshme e policisë.

Sjellje të pahijshme të policisë: Vendime, veprime ose lëshime joligjore, joprofesionale ose joetike, të bëra nga një punonjës policie, duke shkelur parimin e integritetit, qoftë në detyrë, në vend pune apo në jetën private.

Testime integriteti: Operacione të parapara për të identifikuar veprime të mundshme korruptive. Testet e integritetit janë simulime ngjarjesh të cilat në një mënyrë vendosin policin në situatë mbikqyrjeje, që potencialisht mund të veprojnë në mënyrë joetike. Testimet e integritetit janë mënyra të dobishme për parandalimin dhe detektimin e korrupsionit në polici. Ato mund të jenë ose të rastësishme, ose të targetuara, si dhe mund të bëhen pjesë e sistemit të brendshëm të kontrollit të policisë. Testet e targetuara të integritetit poashtu mund të jenë metoda efektive për të hetuar korrupsionin në polici.

Monitorimi/kontrolli i stilit të jetës: Një spektër teknikash që përdoren për të përcaktuar nëse mënyra e jetesës së një zyrtari policie është në përputhshmëri me të ardhurat e regjistruara të atij personi. Një ndryshim i papritur e i pashpjegueshëm i mënyrës së jetesës së një të punësuar mund të jetë indikacion për veprime joligjore.

1. Hyrje në testimin e integritetit

Testimi i integritetit në polici për herë të parë u përdor në qytetin e Nju Jorkut në vitet 1970-1972 nga Komisioni Hetimor i Knapit (Knapp Commission Inquiry – KPMG). Me qëllim të zvogëlimit të korrupsionit brenda Departamentit Policor të Nju Jorkut (New York Police Department – NYPD), Komisioni sugjeroi përdorimin e “operacioneve thumbuese”, gjegjësisht përdorimin e agjentëve të fshehtë, për të simuluar mundësi korrupsioni për policët që dyshohen për sjellje joetike (Knap dhe autorë tjerë, 1972). Që atëherë testimi i integritetit është bërë një mekanizëm vendimtar i kontrollit të brendshëm për departamentet e policisë dhe shembuj të këtillë mund të hasen në Australi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Hungari dhe Rumuni (Prencllër dhe Ronkën, 2001).

2. Testimi i Integritetit dhe monitorimi i stilit të jetës

Korrupsioni dhe llojet e tjera të sjelljes së pahijshme të policisë parandalojnë policinë në kryerjen e detyrave të tyre, duke e bërë atë të duket joefikase, joefektive dhe joprofesionale. Mirëpo, të qenit polici profesionale dhe efikase ka rëndësi kyçe në luftën kundër krimit të organizuar, në përmirësimin e sigurisë publike, fuqizimin e sundimit të ligjit dhe rritjen e besimit publik kundrejt policisë.

Testet e integritetit përdoren për të dekurajuar keqpërdorimet dhe korrupsionin. Ato paraqesin situata të simuluar korrupsioni, me qëllim të detektimit të sjelljeve korruptive ose policëve të korruptueshëm. Gjatë një testi të këtillë, polici nuk është në dijeni që ndaj tij/saj zhvillohet një testim. Ai/ajo vendoset në një situatë mbikëqyrjeje, që ofron një mundësi për sjellje joetike/joligjore. Përmes kësaj, testet e integritetit kanë për qëllim të kopjojnë sfidat dhe presionet e përditshme me të cilat ballafaqohen policët dhe ku ekziston mundësi e madhe për sjellje të këqija.

Edhe pse shpesh përdoren paralelisht, monitorimi i stilit të jetës dhe testimi i integritetit u referohen teknikave të ndryshme të kontrollit të brendshëm. Testimi i integritetit është i fshehtë, përmes krijimit të situatave të simuluar, ndërsa monitorimi i stilit të jetës është i hapur, me përdorimin e teknikave të ndryshme për vlerësimin e sjelljes publike dhe private të një zyrtari publik. Të dyja këto ndihmojnë për të detektuar dhe parandaluar korrupsionin, edhe pse këtë e bëjnë përmes mënyrave të ndryshme.

Ky punim fokusohet në testimin e integritetit, por ngërthen në vete edhe një pjesë të shkurtë lidhur me monitorimin e stilit të jetës. Kontrollat e stilit të jetës, gjegjësisht shqyrtimi i aseteve dhe financave, kanë për qëllim të zbulojnë policët që jetojnë mbi standardin e mundësive që kanë, sepse është shumë e mundshme që ata janë të përfshirë në veprime korruptive që mundësojnë një stil jete të tillë (Houp, 2015). Për shembull, nga secili polic në Policinë Nacionale të Filipineve kërkohet të dorëzojë Deklaratë Vjetore të Pasurisë. Kjo masë u ndërmor pasi që në sipërfaqe dolën pretendime se disa policë shesin narkotikë të ndaluar, të konfiskuar gjatë operacioneve në terren (Agjencia Filipine e Lajmeve, 2019).

3. Rëndësia e testimit të integritetit

Në përgjithësi, ekzistojnë disa arsye pse testimi i integritetit është i rëndësishëm, e të cilat detajisht paraqiten në vazhdim të këtij teksti.

I. Testim integriteti për të detektuar, hetuar dhe ndjekur penalisht shkeljet e integritetit:

Funksioni parësor i testimit të integritetit është që të detektojë, hetojë dhe ndjekë penalisht shkeljet e integritetit. Prova më poshtë tregon se testimi i integritetit, si pjesë e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm, mund të zbulojë dhe parandalojë korrupsionin, si dhe sjellje tjera joetike/joligjore mes policëve.

Pas implementimit të testimit të integritetit në Moldavi, raportimet e brendshme për korrupsion u rritën për 58 %. Rritja i detyrohej thyerjes së “kodit të heshtjes” dhe vullnetit të mirë të zyrtarëve të policisë që të raportojnë dyshime për sjellje të këqija (Dumbravan dhe autorë tjerë., 2013).¹

Për më tepër, implementimi i testimit të integritetit në Departamentin Policor të Nju Jorkut rezultoi me rritje substanciale të numrit të përpjekjeve të raportuara për ryshfet të policëve. Ndonëse në të kaluarën ofertat për ryshfet nuk janë marrë si serioze nga policët, raportimi për to filloi të rritet dukshëm pas realizimit të testimit të integritetit (Poup, 2000).

Në vitin 1999, Policia e Uellsit të Ri Jugor në Australi kreu 90 testime integriteti ku 37% nuk kaluan testin dhe pasuan 51 kallëzime penale (Prencclër dhe Ronkën, 2001). Rrjedhimisht, tre policë u pushuan nga puna dhe 10 policë deponuan dorëheqjen e tyre (Prencclër dhe Ronkën, 2001).

Në vitin 2002, u kryen 486 testime integriteti nga Njësia e Kontrollit të Brendshëm të Departamentit Policor të Nju Jorkut. 54 subjekte që u testuan nuk kaluan testin dhe një pjesë e madhe e këtyre individëve u pushuan nga puna (NYPD, 2002).

II. Testim integriteti për të ndërtuar një rast ndaj një zyrtari tashmë nën hetim:

Siç u tha më lartë, testimi i integritetit mund të shfrytëzohet për të mbledhur prova kundër zyrtarëve që tashmë janë në hetim për dyshim sjelljeje të pahijshme dhe/ose joetike (Parki dhe autorë tjerë, 2011).

¹ Organizata të mbyllura si shërbimet policore kanë tendencë të zhvillojnë kulturë që në thelb është vetëmbrojtëse. Kjo kulturë mund të përshkruhet si i ashtuquajtur i kodit i kaltër ose kodit i heshtjes, i cili është një rregull i pashkruar mes policëve që mos raportohet për gabimet, sjelljet e pahijshme ose krimet e kolegëve.

Shënim: Në disa shtete, provat e siguruara nga testimi i integritetit nuk pranohen në gjykatë. Rrjedhimisht, që të jetë efektiv, testimi i integritetit duhet patjetër të jetë i mbështetur nga një kornizë e përshtatshme ligjore.

“[Qëllimi kryesor i testimit të integritetit] është që në mënyrë proaktive të ‘kapë’ ose ‘pastrojë’ subjektin e vëzhguar. Testimi i targetuar i integritetit mund të kryhet si pjesë e një hetimi kriminal që lidhet me korrupsionin” (Parki dhe autorë tjerë, 2011: Kapitulli 2, faqe 5).

III. Testim integriteti për të parandaluar:

Hulumtimet në kontinuitet kanë treguar se ekzekutimi i dënimit ka efekt më të madh parandalimi se sa ashpërsia e dënimit (Homel, 2002). Testimi i integritetit krijon një ndjenjë pranie të gjerë, me qëllim që policët të trajtojnë çdo rast sikur bëhet fjalë për test integriteti (Rothlejn dhe Rajtër, 2014). Poashtu testi ndihmon të kultivohet një kulturë organizative që nuk toleron sjellje të pahijshme dhe/ose joetike.

Kur arrestohet një polic si rezultat i një hetimi të fshehtë, mund të ketë efekt parandalues te policët tjerë që mund të kenë planifikuar sjellje kriminale, por që frikësohen të mos bëhen objekt hetimi të fshehtë (Rothlejn dhe Rajtër, 2014).

IV. Testim integriteti për të identifikuar rreziqet dhe nevojat:

Rezultatet e testimeve të integritetit mund të përdoren për të identifikuar, si më poshtë:

- Fushat, njësitë apo pozicionet që kanë më së shumti prirje për sjellje të këqija dhe/ose joetike: Ekziston mundësia që disa njësi në polici të jenë më tepër të përfshira në veprime korruptive sesa njësi tjera. Për shembull, rezultatet e testimeve të integritetit në Republikën Çeke treguan se policët e trafikut kishin një numër joproporcional shumë të madh të shkeljeve të integritetit, që çoi në një fushatë antikorrupsion në nivel shtetëror, e që konkretisht targetonte policët e trafikut (Mandiq dhe Gjorgjeviq, 2016).
- Nevojën për legjislacion plotësues antikorrupsion, procedura dhe korrigjim të atyre ekzistuese: Instalimi i kamerave në veturat e policisë në Moldavi u konsiderua si një mekanizëm parandalues kundër shkeljeve të integritetit. Megjithatë, sipas pjesëmarrësve të punëtorisë të PNIP në Moldavi, kur në vitin 2016 policët ishin subjekt i testeve të integritetit, ata thjesht ose mbuluan kamerën ose e drejtuan atë në kahje tjetër, në momentin që pranonin ryshfet nga agjentët e fshehtë.
- Nevojat për trajnim të policëve: Gjetjet nga testet e integritetit mund të përdoren gjithashtu për të hartuar skema trajnimi për zvogëlimin e mundësive të korrupsionit. Për shembull, rezultatet e testimit të integritetit në Uellsin e Ri Jugor, Australi, u përdorën për të identifikuar 96 çështje të menaxhimit, duke çuar në zbatimin e një skeme rajonale të trajnimit të menaxherëve (Prencllër dhe Ronkën, 2001).

- Nevojat për trajnim për njësitë e testimit të integritetit: Gjetjet mund të përdoren më tej për të identifikuar kërkesa shtesë për trajnim për njësinë e testimit të integritetit. Për shembull, zyrtari hetues dhe mbikëqyrësi në Departamentin e Policisë së Nju Jorkut pas çdo testi duhet të plotësojnë një “Formular Rezultati të Testit të Integritetit” (NYPD, 2002). Ky formular përshkruan testin dhe siguron hapësirë që mbikëqyrësi të kritikojë performancën e policit të mbikëqyrur dhe ekipit të testimit (NYPD, 2002).

“Është e rrezikshme të supozohet se vetëm ankesat mund të identifikojnë të gjitha rastet e korrupsionit. Hetimi i korrupsionit fillimisht duhet të jetë proaktiv dhe i mbështetur nga analiza strategjike e informacioneve në dispozicion. Testimi i integritetit bëhet një opsion i rëndësishëm në të gjitha hetimet për sjellje korruptive dhe arrin një numër qëllimesh. Teston sjelljen korruptive dhe etike, përshtatshmërinë e sistemeve dhe procedurave organizative, si dhe paraqet pengesë për policët që mund të ekspozohen ndaj një mundësie korrupsionit” (Prencllër dhe Ronkën, 2001: faqe 329).

V. Testim integriteti për të mbështetur vlerësimet e performacës dhe sistemet e avancimit në karrierë:

Rezultatet nga testimet e integritetit shpesh përdoren gjatë vlerësimit për avancim në karrierë të një zyrtari: të kalosh testimin e integritetit me sukses në shumë forca policore përbën kusht dhe merret parasysh gjatë shqyrtimeve për avancim (Poup, 2000).

Në Moldavi polici duhet ta kalojë me sukses testin e integritetit, që të merret parasysh për pozicionin e Shefit të Policisë (Transparency International, 2014).

4. Llojet e testeve të integritetit

Testet e integritetit ndahen në dy kategori të përafërta: “të targetuara” dhe “të rastësishme”.

Edhe pse testet e integritetit mund të përdoren për të vlerësuar kandidatët para punësimit dhe për të shqyrtuar angazhimin e të punësuarve në shërbim, në polici ato më së shpeshti përdoren për qëllimin e dytë.

Testet e targetuara të integritetit kanë të bëjnë me individë ose grupe specifike. Ata janë pjesë e mekanizmit të kontrollit detektues në një departament policie.

Testimi i targetuar është edhe proaktiv, edhe reaktiv. Është reaktiv sepse zbatohet si përgjigje ndaj pretendimeve ose dyshimeve për sjellje të keqe ekzistuese dhe proaktiv sepse tejkalon metodat tradicionale të hetimit dhe si i tillë ka një efekt parandalues. Më shpesh kjo bëhet “në përgjigje të informacioneve të pranuar ose ankesave që paraqesin një problem korrupsioni, por pa prova adekuate për ndjekje penale të suksesshme kriminale ose interne brenda departamentit” (Prencllër dhe Ronkën, 2001: faqe 321).

Shembull i testimit të targetuar të integritetit

Një ankesë e brendshme ngre dyshime për një polic, duke pretenduar që polici vjedh gjëra me vlerë nga skenat e krimit. Për të vërtetuar këto veprime të papranueshme të policit, inskenohet një vjedhje e rrejshme dhe polici dërgohet në vend të ngjarjes. Në vendngjarje janë vendosur disa gjësende me vlerë për të bërë të mundshme që polici të kryejë vjedhjen.

Testimet e rastësishme të integritetit janë simulime që kryesisht bëhen në mënyrë sistematike sipas rastësisë, sesa që i drejtohen një personi apo grupi specifik.

Shembull i një testimi të rastësishëm integriteti

Një aktor i ofron ryshfet një polici trafiku që e ka ndaluar për tejkalim shpejtësie. Njësia e kontrollit të brendshëm mbikëqyr nëse polici do të refuzojë apo do të pranojë ryshfetin dhe a do ta raportojë përpyjekjen e aktorit për ta korruptuar atë.

Argumentohet se testet e rastësishme të integritetit kanë një faktor më të lartë parandalimi. Shumë policë të përfshirë në korrupsion besojnë se ata kurrë nuk do të vihen në shënjestër pasi e konsiderojnë veten shumë të zgjuar për t'u kapur (Homel, 2002). Por, në testet e rastësishme të strukturuar siç duhet, në mënyrë të barabartë përfshihen të gjithë policët në një departament policie dhe zgjuarësia nuk mund ta shmangë një test të tillë (Homel, 2002).

Megjithatë, disa thonë se testet e rastit janë një humbje resursesh që mund të përdoren diku tjetër (Faull, 2009). Për shembull, oficerët e ndershmë të cilët testohen rastësisht, pengohen përkohësisht të marrin pjesë në një skenë krimi "të vërtetë" (Feull, 2009). Testet e rastësishme janë gjithashtu më të shtrenjta se testet e targetuara për shkak të fushëveprimit të tyre. Prandaj, është ngritur pyetja nëse testimi i rastësishëm mund të jetë tepër i shtrenjtë dhe tepër i vështirë për të mundësuar parandalim kuptimplotë (Homel, 2002). Përveç kësaj, provat sugjerojnë se testet e targetuara të integritetit janë më efektive në zbulimin e korrupsionit (Henri, 1990). Disa nga arsyet janë renditur më poshtë:

- Përshtatja e testimit: Ndryshe nga testet e rastësishme, testet e targetuara zakonisht kryhen brenda kontekstit të një hetimi për sjelljen e gabuar të një polici konkret (Portër dhe Prencllër, 2012). Prandaj, testet e targetuara maksimalisht u janë përshtatur pretendimeve bazë, që do të thotë që polici, nëse në të vërtetë është i korruptuar, ka më shumë të ngjarë të përsërisë sjelljen e gabuar gjatë testit. Për shembull, nëse pretendimet bazë kanë të bëjnë me përdorimin e narkotikëve, testimi i targetuar do të përfshijë një rrethanë interakcioni mes policit të dyshuar dhe narkotikëve (të simuluar).
- Testime më të sofistikuara: Meqenëse testimi i targetuar është i përshtatur, testet mund të jenë më të sofistikuara (Homel, 2002). Për shembull, gjatë përdorimit të testeve të integritetit nga Departamenti i Policisë së Nju Jorkut në vitin 1996, 3% e testeve të rastit u klasifikuan si gama-teste, gjegjësisht forma më komplekse e testimit (Xhirxhenti dhe autorë tjerë, 1996). Në anën tjetër, 36% e testeve të targetuara u klasifikuan si gama-teste (Xhirxhenti dhe autorë tjerë, 1996). Në përgjithësi, skenarët e testeve të rastësishme janë më pak komplekse dhe më pak të sofistikuara, duke e bërë më të lehtë për subjektet e

vëzhguara të kuptojnë se po testohen dhe të ndryshojnë sjelljen e tyre në përputhje me rrethanat.

- Ndërveprimi me stimujt e provës: Është thënë se policët e testuar me teste të targetuara i dallojnë më mirë stimujt e provës, si për shembull para, narkotikë të simuluar ose pronë, sesa në teste të rastësishme. Për shembull, policët e testuar nuk duket se i kanë vërejtur stimujt e provës në 15 nga shqyrtimi i 40 testeve të rastësishme nga Departamenti i Policisë së Nju Jorkut në 1996, respektivisht ata nuk u larguan nga vetura e patrullimit apo nuk bënë madje as pyetje standarde para se të largoheshin nga vendi i ngjarjes (Xhirxhenti dhe autorë tjerë, 1996). Nëse subjektet e vëzhguara nuk marrin pjesë në skenar ose nuk janë në dijeni të ekzistencës së stimujve të provës, ato nuk mund të testohen për sjellje korruptive në një mënyrë të plotë.
- Qasja e vëzhgimit të izoluar nga të tjerët: Provat sugjerojnë që gjatë testeve të rastit, policët më rrallë testohen në mënyrë të izoluar (Homel, 2002). Kjo ilustron nga programi i testimit të integritetit të Departamentit të Policisë së Nju Jorkut në vitin 1996. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 1996, një polic u testua në 18% të testeve të rastit (Xhirxhenti dhe autorë tjerë, 1996). Gjatë së njëjtës periudhë, një polic tjetër u testua gjithsej në 67% të testeve të targetuara (Xhirxhenti dhe autorë tjerë, 1996). Duke qenë se prania e kolegëve mund të zvogëlojë gjasat që policët të përfshihen në sjellje korruptive/joetike për shkak të frikës se mos raportohen, testimi i rastësishëm argumentohet të jetë më pak efektiv. Për më tepër, testet e rastit normalisht fillojnë nga thirrjet në numrat e urgjencës dhe për këtë arsye ka më pak të ngjarë të testojnë policët e dyshuar ndaras nga të tjerët. Megjithatë përdorimi i thirrjeve të urgjencës për të inicuar teste të rastit është e vështirë të shmangët, duke pasur parasysh që metoda tjera mund të ngjallin dyshime, këto thirrje shpesh paralajmërojnë edhe policë tjerë, duke i tërhequr ata në vendin e ngjarjes (Xhirxhenti dhe autorë tjerë, 1996).

Vërejtje përfundimtare për testet e targetuara dhe të rastit

Testet e rastësishme dhe ato të targetuara të integritetit mund të jenë vegla të dobishme për të luftuar korrupsionin dhe sjelljen joetike në polici. Testet e rastësishme mund të jenë efektive nëse ato ushtrohen në një mënyrë të rregullt dhe shumë transparente (Homel, 2002). Megjithatë, kjo mund të bëhet shumë e kushtueshme, duke sugjeruar që testet e targetuara mund të jenë më të përshtatshme për shërbimet e policisë. Përveç kësaj, pasi testet e rastësishme të integritetit mund të jenë të vështira për t'u justifikuar, veçanërisht kur nuk ekziston ndonjë dyshim specifik, testet e targetuara duket se janë më efikase (Epli, 2012).

5. Çfarë duhet të merret parasysh gjatë realizimit të testeve të integritetit?

Para dhe gjatë përdorimit të testeve të integritetit duhet të merren parasysh shumë rrethana.

I. Ato mund të krijojnë klimë mosbesimi brenda departamentit të policisë:

Është sugjeruar se testimi i integritetit mund të krijojë një frymë mosbesimi brenda departamentit të policisë (Homel, 2002). Nëse policët kanë përshtypjen se atyre nuk u besojnë, morali i tyre mund të pësojë rënie (Homel, 2002). Kjo veçanërisht vlen për testimet e rastit. Testimet e targetuara të integritetit në përgjithësi perceptohen si më korrekte, sepse në ato raste dyshohet që subjekti i vëzhguar tashmë është i përfshirë në sjellje joetike/joligjore (Portër dhe Prencllër, 2012). Është me rëndësi që ky ndikim potencial negativ të merret parasysh para kryerjes së testimeve (Rothlejn dhe Rejtër, 2014).

Sidoqoftë, rrënimi i moralit mund të shmanget nëse qëllimi i testeve të integritetit dhe kufizimet e përdorimit të tyre i komunikohen qartë të gjithë stafit. Testet e integritetit fillimisht mund të hasin në rezistencë nga zyrtarët, por ata së shpejti do të kuptojnë se ata që janë të ndershëm nuk kanë arsye për të pasur frikë. Ilustrim përmes një shembulli: para testimit, në Australi u zhvillua një fushatë publicitare, në të cilën departamenti përkatës përdori parullën “policët e ndershëm nuk kanë frikë nga testimi i integritetit”, në mënyrë që të marrin miratim për programin.

Për më tepër, disa autorë madje kanë sugjeruar se brenda departamentit të policisë nevojitet një nivel mosbesimi për të zvogëluar sjelljet e këqija dhe/ose joetike, duke marrë parasysh se mbizotëron kodi i heshtjes (Henri, 1990).

II. Ato mund të jenë të kushtueshme:

Siç u përmend më lartë, është thënë se shpenzimet financiare dhe të kapaciteteve njerëzore që lidhen me kryerjen e testimeve të integritetit janë më të rëndësishme sesa dobia nga to. Kritikët pohojnë se testimi i integritetit, për shkak të kohëzgjatjes dhe pajisjeve të kushtueshme, zhvendos resurset nga funksioni primar i zbatimit të rendit dhe parandalimit të krimit nga ana e policisë (Goldsmith, 2001).

Megjithëse shpenzimet fillestare të zbatimit mund të jenë të mëdha, në plan afatgjatë ekziston mundësia që këto të kompensohen nga një rënie e konsiderueshme e korrupsionit dhe formave tjera të sjelljes së keqe të policisë. Në përgjithësi, testimi i integritetit jep rezultate më të mira për sa i përket shpenzimeve dhe përfitimeve sesa mbështetja tek informatorët ose operativët e fshehtë, të cilët vetëm vëzhgojnë (Millër, 2017). Për më tepër, testimi i integritetit është metoda më e përshtatshme për të luftuar korrupsionin. Metodatat reaktive, si për shembull hetimi i ankesave, shpesh nuk funksionojnë, sepse krimet në fjalë nuk përfshijnë ankesa (Millër, 2017). Sidoqoftë, duhet të ekzistojë një program i duhur i testimit të integritetit për të siguruar efikasitetin e shpenzimeve; nëse testet kryhen rrallë ose në mënyrë të gabuar, ato nuk janë efikase (Homel, 2002).

III. Ato mund të përdoren për të diskredituar rivalët brenda departamentit:

Studiues të ndryshëm kanë argumentuar se taktikat e fshehta, veçanërisht testet e integritetit, mund të keqpërdoren për të diskredituar rivalët brenda departamentit të policisë (Prencllër dhe Ronkën, 2001).

Sidoqoftë, disa masa mund të zbatohen për të zvogëluar gjasat e një sjelljeje të tillë dhe për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të testimit. Njësitë e testimit të integritetit duhet t'i nënshtrohen një trajnimi të specializuar se si të kryejnë operacione të fshehta. Për më tepër, mbikëqyrja ligjore dhe menaxheriale e njësisë së testimit të integritetit duhet të vëzhgohet dhe rishikohet. Një shembull i kësaj do të ishte prania e një komisioni mbikëqyrës që rregullisht shqyrton performancën.

IV. Ato kanë nevojë për kornizë të duhur ligjore:

Së fundmi, testimi i integritetit ngre shqetësime serioze rreth privatësisë, mashtrimit, bllokimit, provokimit dhe të drejtave ligjore të policëve. Prandaj, duhet të ekzistojë legjislacion që rregullon testimin e integritetit dhe përmban kufizime në lidhje me abuzime të mundshme si shkelje të pajustificueshme të privatësisë ose shtytja e një polici për të kryer një krim që ai/ajo përndryshe nuk do ta kryente.

Shënim: Në disa shtete, testimi i integritetit mund të jetë i ndaluar me ligj.

6. Përfundim

Siç përshkruhet në fillim të këtij shënimi përmbledhës, testet e integritetit janë një mekanizëm i dobishëm kur trajtohen probleme korrupsioni që përsëriten. Ato mund të ndihmojnë për të zbuluar, hetuar dhe ndjekur penalisht shkeljet e integritetit të policisë dhe është vërtetuar se parandalojnë shkeljet e pritura. Për më tepër, këto teste mund të përdoren për të identifikuar rreziqet dhe nevojat brenda departamenteve të policisë, si dhe për të mbështetur vlerësimet e performancës ose sistemet e avancimit në karrierë.

Në përgjithësi, agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të marrin parasysh katër pikat në vijim, para se të kryejnë teste integriteti:

- Testimet janë të kushtueshme;
- Testimet mund të krijojnë një ndjesi mosbesimi nëse nuk ka komunikim të qartë për qëllimin dhe kufizimet e tyre;
- Testimet mund të shpërdorohen për të diskredituar rivalët brenda departamentit, nëse ato nuk janë të rregulluara në mënyrën e duhur;
- Testimet kërkojnë kornizë të duhur ligjore, për të siguruar efikasitet dhe privaci.

Në të gjitha rastet, pilot-programet duhet të realizohen para se të investohet në teste të shtrenjta për të identifikuar sfidat e mundshme. Sidoqoftë, suksesi i programeve të testimit të integritetit në identifikimin e sjelljeve të pahijshme sugjeron që përfitimet e përgjithshme tejkalojnë kostot. Për të përmirësuar sjelljen e policisë rekomandohet realizim i testimeve të integritetit policor.

7. Referencat

- Dumbravan, Christina. ed., *Annual Activity Report* (Chisinau: National Integrity Commission of Moldova, 2013).
- Faull, Andreë, 'Taking the Test: Police Integrity and Professionalism in the MPDs', *South African Crime Quarterly* Vol. 27 (2009): pp. 3-6.
- Girgenti, Richard et al., *Report to The New York City Commission to Combat Police Corruption* (New York: KPMG, 1996).
- Goldsmith, Andrew, 'The Pursuit of Police Integrity: Leadership and Governance Dimensions', *Paper presented at the Griffith University Police Integrity Symposium Brisbane* (2011).
- Henry, Vincent, 'Lifting the Blue Curtain: Some Controversial Strategies to Control Police Corruption', *National Police Research Unit Review* Vol. 6 (1990): pp. 48-55.
- Homel, Ross, 'Integrity Testing' in *Police Reform: Building Integrity* (Sydney: Hawkins Press, 2002), pp. 159-171.
- Hope, Kempe Ronald Sr., *Police Corruption and Police Reforms in Developing Societies* (Taylor & Francis Ltd., 2015).
- Knapp, Whitman et al., *The Knapp Commission Report on Police Corruption* (New York: George Braziller, 1972).
- Mandic, Sofija, and Sasa Djordjevic, *Testing the Integrity of Police Officers*, (Belgrade: Belgrade Centre for Security Policy, 2016).
- Miller, Seumas, 'An Anti-Corruption System for Police Organisations' in *Designing in Ethics* (Cambridge: Cambridge University Press, 2012), pp. 173-191.
- New York Police Department (NYPD), *Internal Affairs Bureau Annual Report* (New York: NYPD, 2002).
- Transparency International, *National Integrity System Assessment Moldova* (Chisinau: Transparency International, 2014).
- Parke, Melissa et al., *Inquiry into Integrity Testing* (Canberra: Parliamentary Joint Committee on the Australian Commission for Law Enforcement Integrity, 2011).
- Philippine News Agency, 'PNP Welcomes Lifestyle Check on Cops' (8 October 2019).
- Pope, Jeremy, *Public Service Ethics, Monitoring Assets and Integrity Testing* (Berlin and London: Transparency International, 2000).
- Porter, Louise and Tim Prenzler, 'Corruption Prevention and Complaint Management' in *Policing and Security in Practice: Challenges and Achievements* (Basingstoke and New York: Palgrave Macmillan, 2012), pp. 130-148.
- Prenzler, Tim and Carol Ronken, 'Police Integrity Testing in Australia', *Criminology and Criminal Justice* Vol. 1: No. 3 (2001), pp. 319-342.

Rothlein, Steve and Lou Reiter, *Conducting Covert Investigations, Integrity Tests and Financial Investigations on Law Enforcement Employees* (Indianapolis: PATC Legal & Liability Risk Management Institute, 2014).

Përmbledhje e resurseve me të cilat disponon DCAF në lidhje me testimet e integritetit

Doracaku i DCAF për Integritetin e Policisë synon të ndihmojë shërbimet e policisë në hartimin e masave efektive për të parandaluar korrupsionin policor, duke rritur aftësinë e tyre për të luftuar krimin, duke përmirësuar sigurinë publike dhe duke forcuar sundimit të ligjit dhe besimin e publikut në polici. Kapitujt 5 dhe 7 shqyrtojnë kontrollin e brendshëm dhe teknikat e hetimit, përfshirë testimin e integritetit. Është në dispozicion në vegzën në vijim: <http://www.dcaf.ch/Publications/Toolkit-on-Police-Integrity>.

Doracaku i Trajnimit i DCAF mbi Integritetin e Policisë synon të ndihmojë ministrat e punëve të brendshme, shërbimet e policisë dhe institucionet e trajnimit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre për t'i ofruar stafit të tyre trajnime për integritetin. Moduli 7 merret me përgjegjësinë e policisë, përfshirë testimin e integritetit. Është në dispozicion në vegzën në vijim: <http://www.dcaf.ch/Publications/Training-Manual-on-Police-Integrity>.

Kontakt

Paulo Kosta, Drejtues i Programit të Policisë në DCAF

DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance

Adresa:

Chemin Eugène-Rigot 2E

CH-1202 Gjenevë

Zvicër

☎ +41 22 730 9455

✉ p.costa@dcaf.ch

DCAF Qendra e Gjenevës
për Qeverisjen e
Sektorit të Sigurisë

P.O.Box 1360
CH-1211 Geneva 1 Switzerland

✉ info@dcaf.ch

☎ +41 (0) 22 730 9400

www.dcaf.ch

🐦 [@DCAF_Geneva](https://twitter.com/DCAF_Geneva)